


ProCredit Bank

ProCredit ESG

Raporti i Ndikimit

www.procreditbank-kos.com

BULETINI, Q2/2023

Bankim i përgjegjshëm në praktikë – Çfarë ka të re?

Këtë vit, Raporti i Ndikimit u botua si një dokument me dy pjesë, i quajtur Pako e Raportit të Ndikimit 2022, i përbërë nga këto elemente:

- Raporti i Ndikimit 2022
- Fleta e të dhënave e Raportit të Ndikimit 2022 (analizë e plotë e fakteve dhe shifrave)

Pako e plotë e Raportit të Ndikimit 2022 mund të gjendet në faqen e internetit të ProCredit Holding.

Ky raport është përgatitur për herë të gjashtë në përputhje me Standardet e Nismës Globale të Raportimit ("Global Reporting Initiative" - GRI) dhe është në përputhje me kërkesat dhe detyrimet rregullatore, si p.sh. NFRD evropiane, si dhe me kornizën nënshkruese, duke përfshirë:

- UN Global Compact
- Nisma e OKB për Financimin e Programit Mjedisor – Parimet për Bankim të Përgjegjshëm
- Partneriteti për Kontabilitetin Financiar të Karbonit

cument
nd



Pikat kryesore dhe arritjet me pak fjalë

Në tri seksionet e mëposhtme, paraqesim zhvillimet e fundit brenda grupit. Shembujt e përzgjedhur dhe rastet praktike theksojnë arritjet tona ekonomike, mjedisore dhe sociale në vitin 2022.



Qasja jonë e përgjegjshme sociale (shih faqet 27 e tutje)

Arritjet dhe pikat kryesore:

Mbështetja për Ukrainën

- Ne mbështetëm NVM-të me nevojë urgjente për kapital punues si dhe fermerët me furnizimin e farërave.
- Ne i zhvendosëm të gjitha të dhënat dhe infrastrukturën tonë të TI-së në mjedisin tonë "Cloud" në Frankfurt për të rritur qëndrueshmërinë

Vlera të përgjegjshme, udhëzime për veprim dhe struktura organizative

- Ne morëm vendimin të mos financojmë më projekte FV që përdorin panele diellore të prodhuara nga kompani të përfshira në punë të detyruar në rajonin Xinjiang të Kinës
- Përmirësuam procesin tonë të vlerësimit të rrezikut që lidhet me klimën


Qëllimi: Zero Neto

- Ne jemi zotuar të ndjekim parimet e "Net-Zero Banking Alliance" dhe të "Science Based Targets initiative"
- Kjo do të thotë se ne si ProCredit po angazhohemi në një rrugë drejt dekarbonizimit të aktivitetit tonë të kredithënies, në përputhje me objektivat e Marrëveshjes së Parisit

Portofoli i kredive

- 91% e kredive tona i drejtohen ndërmarrjeve shumë të vogla, të vogla dhe të mesme
- 39% e portofolit tonë të kredive mbështet bujqësinë dhe prodhimin
- Portofoli ynë i kredive mbeti i qëndrueshëm edhe pas krizës së COVID-19 dhe gjatë trazirave në Ukrainë të shkaktuara nga pushtimi rus
- Përqindja e kredive me probleme qëndroi në një nivel të ulët e stabil prej 3.3% (2.4% pa përfshirë Ukrainën)

Rëndësia e NVM-ve në vendet ku ne operojmë





Përkushtimi ynë ndaj mjedisit (shih faqe 55)

Arritjet dhe pikat kryesore:

Portofoli i kredive të gjelbra

- Kemi arritur cakun tonë afatmesëm për ta rritur portofolin e kredive të gjelbra në mbi 20% të totalit të portofolit të kredive
- Investimet në efikasitet të energjisë dhe energji të ripërtërishme janë rritur për 9.1%
- Mbi 50% e rritjes së përgjithshme të portofolit të grupit vjen nga kreditë e gjelbra
- Taksonomia e BE-së: 50% e kritereve tona për kredidhënie të gjelbër tashmë pasqyrojnë kriteret teknike të përmendura në taksonomi (faqe 66)

Mbështetja e tranzicionit lokal energjetik

- Numri i kredive të disbursuara për panelet FV në çati pothuajse u dyfishua në vitin 2022
- Kapaciteti i përgjithshëm i projekteve FV në çati të financuara nga ProCredit është 162 MWp
- 272 mbushës elektrikë (E-chargers) janë instaluar dhe janë në dispozicion për përdorim publik

Ndryshimet klimatike


- Sistemet tona FV kanë prodhuar 428 MWh në vitin 2022 (një rritje prej 8%)
- Arritëm një reduktim prej 12% të emetimeve në Fushëveprimin 1 dhe 2 krahasuar me vitin 2021
- Kemi mbledhur 2.8 ton mbetje elektronike (e-waste), prej të cilave 100% janë ricikluar
- Kemi mbledhur 5.1 ton mbetje letre, prej të cilave 100% janë ricikluar
- Kemi zvogëluar konsumin e energjisë në ndërtesat tona me 11% krahasuar me vitin 2021

- Për të dytin vit radhazi, ne kemi raportuar emetimet e CO₂ të klientëve tanë në përputhje me standardet e PCAF: 770 kilotonë në vitin 2022

Zhvillimet në strategjinë tonë për plastikën (shih faqe 61)

- Ne u bëmë anëtarë të “Finance Leadership Group on Plastics”
- Ne i ruajmë kontaktet e ngushta me klientët e përfshirë në plastikë njëpërdorimshme dhe do të vazhdojmë t'i mbështesim në tranzicionin e tyre
- Fatkeqësisht, ndonjëherë është e domosdoshme të ndajmë rrugët me klientët, strategjitë e të cilëve janë të papajtueshme me tonat, për sa i përket ndalimit të shitjes dhe prodhimit të plastikës njëpërdorimshme.
- Deri më tani, na është dashur të ndërpresim bashkëpunimin me 25% të klientëve tanë që shesin ose prodhojnë produkte plastike njëpërdorimshme, pasi ata nuk ishin në gjendje ose nuk dëshironin t'i harmonizonin praktikën e tyre të biznesit me Strategjinë tonë për Plastikën

Zhvillimi i PK të Gjelbër





Njerëzit tanë (shih faqet 73)



Arritjet dhe pikat kryesore:

Publikimi i deklaratës për të drejtat e njeriut:

Përmbledhja e parimeve dhe standardeve tona lidhur me të drejtat e njeriut në një deklaratë publike

Investimi në njerëz (shih infografikën në faqen 86)

- 493,514 orë trajnimi të ofruara për stafin
- 8,843 orë trajnimi për Kodin e Sjelljes
- 7.4 milionë EUR investim në trajnimin e punonjësve (një rritje prej 15% krahasuar me 2021)
- 226 kolegë të rinj iu bashkuan kompanisë përmes Programit tonë gjashtëmujor të "Onboarding"



Mjedis pune fleksibil dhe stimulues

- 50% e menaxhmentit të mesëm në 12 bankat e grupit ProCredit janë femra (48% për të gjithë grupin)
- Kalimi i suksesshëm i punës në zyrë pas pandemisë
- Buxhet fleksibil për punë në distancë
- Mjedis pune pozitiv i karakterizuar nga diversiteti, hierarkitë e sheshta dhe komunikimi i hapur
- Përfitime të ndryshme jomonetare: Biletë transporti, makina e përbashkët e kompanisë, sigurim shëndetësor privat, plane private pensionale, anëtarësim në klube fitnesi, sigurim ndaj aksidenteve, mundësi për marrje me qira të biçikletave, etj.

Rinovimi i kopshtit të fëmijëve në Shqipëri (shih faqe 77)

- Si pjesë e Projektit të Solidaritetit të ProCredit, një kopsht fëmijësh i dëmtuar nga tërmeti në Tiranë u rinovua plotësisht dhe tani është eficient në aspektin e energjisë
- Stafi i grupit ProCredit mbledhi donacione përmes aktiviteteve të ndryshme për mbledhje të fondeve për ta mbështetur këtë projekt

Gjithsej punonjës



Femra 38%


Meshkuj 62%

Qëllimet e qëndrueshmërisë dhe arritjet në vitin 2022

Në 2018, grupi ProCredit ia vendosi vetes tri qëllime afatmesme sa i përket qëndrueshmërisë. Ky seksion përmbledhë progresin e arritur në arritjen e këtyre qëllimeve gjatë vitit të kaluar.

20% KREDI TË GJELBRA DERI NË 2023

Qëllimi: Rritja e pjesës së portofolit të kredive të gjelbra të grupit në 20% të totalit të portofolit të kredive, duke ruajtur njëkohësisht cilësinë e lartë të veprimtarisë sonë të



Madhësia e portofolit të kredive të gjelbra në fund të 2022: EUR 1,231.1 m

Rritja e përqindjes së portofolit të kredive të gjelbra në portofolin e përgjithshëm në 2022 përgjatë një viti: 1.2%

Kreditë për investime të gjelbra si përqindje e totalit të investimeve të gjelbra: 26%


Numri i kredive është rritur krahasuar me vitin 2021 në dy kategori: investimet në efikasitet të energjisë (EE) që ulin konsumin e energjisë për të paktën 20% dhe investimet në energji të ripërtëritshme (ER) në sisteme gjenerimi të shpërndara ose të shkallës shërbyese

Vëllimi i kredive është rritur në krahasim me 2021 në dy kategori:

investimet RE në sisteme gjenerimi të shpërndara ose të shkallës shërbyese dhe investime të tjera miqësore ndaj mjedisit, si menaxhimi i mbeturinave apo bujqësia organike

NEUTRALITETI NË KARBON DERI NË 2023

Qëllimi: Të bëhemi neutral në karbon sa i përket emetimeve të CO₂ të vet grupit



Fazat përfundimtare të ndërtimit të parkut tonë FV 3 MWp në Kosovë (ProEnergy) për të kompensuar pjesën më të madhe të emetimeve tona të Fushëveprimi 1 dhe 2

Që nga viti 2021, rritje prej 11% në prodhimin e energjisë nga sistemet tona FV në çati (kapacitet maks i instaluar rreth 449 kWp në dhjetor 2022) në 8 banka dhe në Akademinë ProCredit


Certifikimi EDGE i zyrave qendrore të bankës në Kosovë, që do të thotë se tani kemi 5 ndërtesa me certifikimin EDGE në nivel grupi

38% e flotës sonë të automjeteve është elektrike, 25% hibride dhe 14% "plug-in" hibride

Që nga viti 2021, kemi një reduktim prej 11% në konsumin total të energjisë në ndërtesat tona

KOMPETENCAT E STAFIT

Qëllimi: Ruajtja dhe rritja e mëtejme e nivelit të lartë të kompetencave sociale dhe mjedisore në mesin e stafit



Trajnimit mjedisor i janë kushtuar gjithsej: 10,048 orë

Në 2022, trajnimi i avancuar për

- Mirëqenien e kafshëve (vazhdon në 2023): 1,300 pjesëmarrës dhe 400 orë trajnim
- Vlerësimi M&S për ZRRM-të: 40 pjesëmarrës dhe më shumë se 2,000 orë trajnim (të ndara midis mësimit përmes LMS dhe një trajnimi 5 ditor me pjesëmarrje fizike në PCA)

Orët që i janë kushtuar trajnimit për Kodin e Sjelljes: 8,843 Fokusi kryesor i diskutimeve në 2022: Të drejtat e njeriut në kontekstin e pretendimeve për punë të detyruar në lidhje me zingjirin e furnizimit të paneleve FV.